

**POLITIKAT E SEKTORIT TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE –  
AXHENDA DIXHITALE PËR KOSOVËN  
2013 ÷ 2020**

Dhjetor 2012

# Përmbajtja

<b>Akronimet</b> .....	4
<b>1. Përmbledhje ekzekutive</b> .....	5
<b>2. Hyrje:</b> .....	7
<b>3. Metodologjia:</b> .....	8
<b>4. Sfondi:</b> .....	10
4.1. <i>Fusha problemore: Zhvillimi i infrastrukturës së TIK</i> .....	13
4.2. <i>Fusha problemore: Zhvillimi i shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike dhe promovimi i shfrytëzimit të tyre</i> .....	15
4.3. <i>Fusha problemore: Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut</i> .....	16
4.4. <i>Fushat tjera problemore:</i> .....	18
<b>5. Objektivat</b> .....	21
<b>6. Alternativat e konsideruara</b> .....	21
<b>7. Qasja e rekomanduar</b> .....	21
<b>8. Hapat e ardhshëm, për zbatimin e strategjisë – Zbatimi i Politikave dhe llogaridhënia</b> .....	23
<b>9. Aneks</b> .....	1

## **Akronimet**

ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
BE	Bashkimi Evropian
BPK	Bruto Prodhimi Kombëtar (ang.GDP)
ccTLD	Kodi Shtetëror për Krye-Domen (ang. country code Top Level Domain)
CERT	Ekipi për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (ang. Computer Emergency Response Team).
ECDL	Licenca Evropiane për Përdorim të Kompjuterit (ang. European Computer Driving Licence)
eSEE Initiative	Iniciativa elektronike e Evropës Juglindore
gTLD	Krye-Domeni gjenerik (ang. generic Top-Level Domain)
ICANN	Korporata e Internetit për Caktimin e Emrave dhe Numrave (ang. Internet Corporation for Assigned Names and Numbers)
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PTK	Posta dhe Telekom i Kosovës Sh.A.
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
QeK	Qeveria e Kosovës
STIKK	Shoqata e Teknologjisë Informativë dhe Komunikuese e Kosovës
TAIEX	Asistenca Teknike për Shkëmbimin e Informacionit (ang. Technical Assistance Information Exchange)
TID+	Sot Vendosi Unë Plus (ang. Today I Decide Plus)
TIK	Teknologjia Informativë dhe Komunikuese
TM1/2/3/4	Tremujori 1/2/3/4

## **1. Përmbledhje ekzekutive**

Ky dokument përmban politikat e sektorit të Komunikimeve Elektronike të Qeverisë së Kosovës (QeK) siç janë propozuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për një periudhë kohore afatmesme deri afatgjatë (e nënkuptuar që t'i destinohet periudhës kohore deri në dhjetor të vitit 2016 dhe, në mënyrë më të përgjithshme, periudhës pasuese katërvjeçare deri në dhjetor të vitit 2020).

Politikat e sektorit të Komunikimeve Elektronike – Agjenda Dixhitale për Kosovën 2013–2020 (në tekstin e mëtejme “Politikat”) janë hartuar duke pasur parasysh se zhvillimi i teknologjisë informative dhe komunikuese (në tekstin e mëtejme “TIK”) është proces dinamik dhe që vazhdimisht pëson ndryshime të shpejta në fusha të shumta të aktiviteteve publike dhe shtetërore, dhe përfshirja e suksesshme e sektorit publik në promovimin e efekteve pozitive dhe minimizimin e atyre negative në këtë proces është kontribut i madh në zhvillimin e qëndrueshëm të Shoqërisë së Informacionit.

Qëllimi i Politikave është që të përkufizohen prioritetet, objektivat dhe detyrat e zhvillimit të TIK-ut për t'i maksimizuar përparësitë sociale dhe ekonomike që i ofrojnë ato teknologji, kryesisht Interneti, si instrument shumë i rëndësishëm për aktivitete ekonomike dhe sociale, shfrytëzimi i të cilit mundëson ofrimin apo pranimin e shërbimeve, punëve, qasje në argëtim, komunikim dhe shprehje të lirë të mendimeve.

Politikat trajtojnë Shoqërinë e Informacionit si shoqëri të hapur dhe të arsimuar, pjesëtarët e së cilës përdorin TIK-un në mënyrë efektive në të gjitha fushat e aktiviteteve.

Objektivi strategjik i Politikave është përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e Kosovës si dhe mjedisit afarist për kompanitë përmes shfrytëzimit të mundësive të krijuara nga TIK-u dhe rritja e përqindjes së përdoruesve të internetit në Kosovë deri në së paku 85 % deri në vitin 2020.

Objektivat kryesore të këtyre politikave janë:

1. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut (në tekstin e mëtejme “Prioriteti 1”);
2. Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre (në tekstin e mëtejme “Prioriteti 2”);
3. Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut (në tekstin e mëtejme “Prioriteti 3”).

Duke marrë parasysh analizën e fushave problemore të trajtuara në Kapitullin 4, si dhe objektivat strategjike të sugjeruara për të adresuar ato fusha dhe alternativat e diskutuara në Kapitullin 6, si dhe kontributet e ofruara nga institucionet pjesëmarrëse dhe palët e interesit janë përpiluar veprimet të paraqitura në formë të tabelës në Aneksin e këtyre Politikave. Tabela përfshin objektivat, kriteret e vlerësimit, institucionet përgjegjëse, afatet kohore për zbatimin e aktiviteteve.

Për Prioritetin 1 “Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut” janë përcaktuar objektivat si në vijim:

1.1. Objektivi i parë është që të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik i rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjera (broadband) në tërë territorin nacional dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike (në tekstin e mëtejme “Objektivi 1 i Prioritetit 1”).

1.2. Objektivi i dytë është që të arrihet siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të rritur besimin e publikut dhe bizneseve në hapësirën kibernetike (në tekstin e mëtejme “Objektivi 2 i Prioritetit 1”).

Për Prioritetin 2 “Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre” janë përcaktuar objektivat si në vijim:

2.1. Objektivi i parë është që të inkurajohen banorët në shfrytëzimin e shërbimeve publike dhe administrative online, si dhe të sigurohet cilësia e bartjes së të dhënave dhe infrastruktura e funksionimit të sistemeve të kërkimit, duke kontribuar në zhvillimin e e-demokracisë (në tekstin e mëtejme “Objektivi 1 i Prioritetit 2”).

2.2. Objektivi i dytë është përdorimi i TIK-ut për të promovuar kulturën dhe gjuhët e Kosovës (në tekstin e mëtejme “Objektivi 2 i Prioritetit 2”).

2.3. Objektivi i tretë është promovimi i zhvillimit të e-biznesit (në tekstin e mëtejme “Objektivi 3 i Prioritetit 2”).

Për implementimin e Prioritetit 3 “Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut” është përcaktuar objektiva si në vijim:

3.1. Është objektiv që të inkurajohen banorët e Kosovës që t’i përvetësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për përdorim të suksesshëm të TIK-ut dhe të përfshihen në Shoqërinë e Informacionit, për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetës dhe për të zvogëluar përjashtimin e tyre social (në tekstin e mëtejme “objektivi 1 i Prioritetit 3”), si dhe të krijojnë kushtet e nevojshme për këtë.

Përveç këtyre prioritetëve dhe objektivave për adresimin e prioritetëve, një numër i caktuar i objektivave dhe veprimeve të kërkuara në dokumentin e kaluar të “Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit” të vitit 2007 janë adresuar (plotësuar) në Ligjin për Komunikimet Elektronike Nr. 04/ L-109 të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 04.10.2012.

## **2. Hyrje:**

Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme se komunikimet elektronike janë një komponentë kritike e një vargu të gjerë të aktiviteteve ekonomike kombëtare, jetike për krijimin dhe kultivimin e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, si dhe vendimtare në kohezionin shoqëror dhe në përhapjen e dijes tek të gjitha shtresat e shoqërisë. Industria e TIK-ut përgjithësisht përbën një sektor të fuqishëm të ekonomisë, duke siguruar një burim të rëndësishëm të punësimit, duke kontribuar me një pjesë të rëndësishme të Bruto Prodhimit Kombëtar (në gjashtë vitet e fundit 8%-11% e BPK – ang.GDP), si dhe duke shërbyer si një katalizator për krijimin e një fuqie punëtore me kualifikim të lartë për një ekonomi të bazuar në dije.

Prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në këto Politika korrespondojnë me objektivat e përcaktuara në Kapitullin 1.4 "Transporti dhe Telekomunikacioni" i programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, respektivisht Reformën e Legjislacionit në fushën e telekomunikacionit; Marrjen e Kodit shtetëror për shërbimet e telefonisë, si dhe domenit shtetëror për shërbimet e internetit; Rritjen, zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës brezgjere të komunikimeve elektronike, shërbimeve telefonike, postare dhe të internetit.

Prioritetet e këtyre Politikave janë gjithashtu të lidhura edhe me veprimet e parapara në kuadër të "Planit të Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011 - 2014", gjegjësisht me prioritetin 2. – Investimet, mjedisi investues dhe përkrahja e sektorit privat; 2.1 Përmirësimi i ambientit të biznesit; dhe 2.3 Përmirësimi i proceseve të hartimit të ligjeve dhe rregulloreve dhe rritja e parashikueshmërisë dhe transparencës përmes krijimit dhe institucionalizimit të një baze të konsoliduar të të dhënave për sektorin e ekonomisë; 2.5 Përmirësimi i koordinimit dhe efikasitetit dhe ulja e kostos së zhvillimit të sistemeve automatike të qeverisjes.

Brenda kontekstit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (ish Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore) – Iniciativës Elektronike për Evropën Juglindore (eSEE Initiative), Qeveria e Republikës së Kosovës përmes marrjes së vendimit Nr.02/248 të datës 02.04.2007 ka bërë zotime konkrete për të zbatuar veprimet që rrjedhin nga "eSEE Agjenda Plus për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Evropën Juglindore 2007 - 2012"<sup>1</sup>, në fushën e TIK-ut që nënkupton se veprimet përkatëse duhet të merren në fushat e përcaktuara, si p.sh. Disponueshmëria e rrjeteve brezgjera të shpejtësisë së lartë dhe shërbimeve të sigurt; Zhvillimi dhe qasja e përmbajtjes së pasur online dhe transferimi nga forma konvencionale; Risi dhe investime në hulumtim dhe edukim në TIK; Shoqëri gjithëpërfshirëse e Informacionit; etj.

---

<sup>1</sup> Në Konferencën Ministrore në Tiranë, datë 07.11.2011 është miratuar dokumenti i "eSEE Agjendës Plus me afate të rishikuara".

Hartimi i këtyre Politikave është paraparë në Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike për vitin 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2012 i aprovuar nga Qeveria parasheh veprime të caktuara të cilat duhet të merren në kuadër të prioritetit për Shoqëri të Informacionit dhe Media, që përfshinë "Rishqyrtimin e Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit dhe hartimin e Politikave të sektorit të Komunikimeve Elektronike" dhe për hartimin e tyre duhet të konsiderohen si udhërrëfyes dokumentet relevante dhe aktet ligjore të Bashkimit Evropian. Prandaj Politikat janë në përputhje me objektivat e përcaktuara në Komunikatën e Komisionit Evropian të datës 19 maj 2010 për Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve "Akhenda Dixhitale për Evropën " (COM (2010) 245 final) dhe e bashkërenduar me Komunikatën e Komisionit Evropian të datës 3 mars 2010 "Strategjia për rritje të mençur, të qëndrueshme dhe përfshirëse" (COM (2010) 2020 final).

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) si Ministri përgjegjëse për sektorin e komunikimeve elektronike në bazë të Ligjit për Komunikime Elektronike (Neni 7) ka përgjegjësi dhe kompetencë hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare për sektorin e komunikimeve elektronike.

### **3. Metodologjia:**

Në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë të gjitha palët e interesit nga sektori publik, dhe privat, si dhe është ndihmuar nga ekspertët e Bashkimit Evropian përmes misionit të TAIEX-it.

Procesi i konsultimeve është bërë me përfaqësues të institucioneve vendore, rajonale dhe akterëve të interesuar si vendor ashtu edhe ndërkombëtar.

Procesi i konsultimeve është zhvilluar prej gushtit 2012 e cila ishte edhe data e fillimit të draftimit të këtij dokumenti.

Grupi Punues është themeluar në bazë të Vendimit Nr. 2096 të datës 07.09.2012 nga Sekretari i Përgjithshëm i MZHE-së dhe është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve si në vijim:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
2. Ministria e Infrastrukturës;
3. Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;
4. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

6. Ministria e Administratës Publike;
7. Komisioni i Pavarur për Media ;
8. Ministria e Financave;
9. Ministria e Integritit Evropian.

Ky Grup Punues ka bërë analizat dhe ka dhënë rekomandimet, duke u bazuar në Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 të miratuar nga Qeveria e Kosovës për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm i metodologjisë së përdorur nga grupi punues ishte qasja ciklike ndaj zhvillimeve të strategjisë, e përbërë nga tri faza të bashkërenditura dhe interaktive që janë, analiza, zhvillimi i strategjisë, vendosja e objektivave dhe aktiviteteve të qarta.

Ky grup punues ka punuar në takime të rregullta, duke bërë analiza dhe ofruar informata relevante për fushat specifike dhe çështjet që trajtohen në këtë dokument, duke sugjeruar objektiva dhe aktivitete specifike.

Rezultati: Drafti final i hartuar nga anëtarët e Grupit Punues i sipër përmendur.

Janë organizuar takime të veçanta me Entitetet si në vijim: Agjencia e Statistikave të Kosovës; Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë; Operatorët e telekomit: IPKO, PTK; Shoqata e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese e Kosovës (STIKK); Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Nga këto entitete janë marrë komente, sugjerime dhe informacione të mjaftueshme brenda kornizës që kërkohet në bazë të kompetencave përkatëse si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi.

Ekspertiza e Komisionit Evropian:

MZHE përmes Departamentit të Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative ka aplikuar për konsulencë teknike nga Komisioni Evropian, me qëllim të asistimit të MZHE-së për zbatimin e veprimit të paraparë në PVPE 2012 dhe në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, ku kërkohet rishikimi i Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit 2007 si dhe përgatitja e Dokumentit të ri të Politikave të Sektorit të Komunikimeve Elektronike.

Rishikimi i dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të vitit 2007 ka qenë pjesë e misionit të asistencës teknike të TAIEX-it dhe është marrë parasysh gjatë përpilimit të dokumentit të Politikave të sektorit të Komunikimeve Elektronike.



Për këtë qëllim MZHE është asistuar nga ekspertët e fushës përkatëse për komunikimet elektronike nëpërmjet TAIEK.

#### Konsultimet Publike:

Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë konsultime dhe janë marrë komente zyrtare nga Operatorët: PTK dhe IPKO, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK).

Komentet nga këto entitete janë marrë parasysh në draftin final të Politikave të Sektorit të Komunikimeve Elektronike.

#### **4. Sfondi:**

Teknologjia Informative dhe Komunikuese është njëra nga teknologjitë më të rëndësishme që ndikon në jetën e njeriut, dhe në aktivitetet e tija të përditshme.

Në sferën ekonomike, disponueshmëria e një shumëllojshmërie të shërbimeve telekomunikuese moderne, i ndihmon bizneset në rritjen e prodhimit dhe të rendimentit përmes krijimit të teknikave prodhuese më efikase dhe uljes së kostos së koordinimit të aktiviteteve ekonomike brenda dhe në mes të bizneseve.

Në sferën shoqërore, qasja gjithëpërfshirëse drejt besueshmërisë, çmimet transparente, cilësia e mirë e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike ndihmojnë në ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të të qenit të informuar, si dhe lehtësojnë disponueshmërinë e një vargu të gjerë të shërbimeve qeveritare.

Në sektorin publik, ka prova të konsiderueshme që tregojnë se komunikimet elektronike mund të jenë një instrument i fuqishëm në përkrahje të transparencës, përgjegjësisë dhe efikasitetit të qeverisë.


Prandaj, sektori i TIK-ut, duke përfshirë të gjithë gamën e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të Shoqërisë së Informacionit, është njëri nga sektorët shërbyes më të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.

Mungesa e një kornize të konsoliduar institucionale për një shoqëri të bazuar në TIK, gjegjësisht një dokumenti strategjik kornizë, për koordinimin e veprimeve në sektorin publik brenda fushës së TIK, bën gjithnjë e më të vështirë zhvillimin e sektorit të TIK, bën veprimet e institucioneve publike të pa harmonizuara, që duplikojnë njëra-tjetrën, jo efikase dhe për këtë arsye mos krijimin e ambientit të favorshëm për investime private në kuadër të sektorit.

Gjendja e Sektorit të Komunikimeve Elektronike si penetrimi i Internetit, telefonisë mobile, telefonisë fikse është ilustruar me grafiket si në vijim:

Grafiku 1 pasqyron gjendjen e penetrimit të Internetit në kuptim të përqindjes së numrit të linjave për numër të shtëpive, sipas të dhënave zyrtare të raportuara nga operatorët.


Graf. 1 – Penetrimi i Internetit



Burimi: ARKEP: Publikim 02/2012, i datës 10 dhjetor 2012.

Ndërsa grafiku 2 pasqyron penetrimin e internetit brezgjërë në Kosovë (XK) krahasuar me shtetet e rajonit dhe me mesataren e Bashkimit Evropian.


Graf. 2 – Penetrimi i Internetit brezgjërë në Kosovë (XK) krahasuar me shtetet e rajonit të Evropës Juglindore dhe mesataren e vendeve të BE-27



Burimi: Cullen International, Raporti 2, Korrik 2012

Grafiku 3 pasqyron gjendjen e penetrimit të telefonisë fikse në kuptim të numrit të linjave për banor.


Graf. 3 – Penetrimi i telefonisë fikse



Burimi: ARKEP: Publikim 02/2012, i datës 10 dhjetor 2012

Grafiku 4 pasqyron gjendjen e penetrimit të telefonisë mobile në Kosovë.

Graf. 4 – Penetrimi i telefonisë mobile



Burimi: ARKEP: Publikim 02/2012, e datës 10 dhjetor 2012

Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Agjenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020 adresojnë këto fusha problemore: zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut; zhvillimi i shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike si dhe promovimin e përdorimit të tyre; dhe rritjen e aftësisë së banorëve të Kosovës për përdorimin e TIK-ut.

#### **4.1. Fusha problemore: Zhvillimi i infrastrukturës së TIK**

E ardhmja e aktiviteteve ekonomike, sociale dhe aktiviteteve tjera është e paimagjinueshme pa përdorim të internetit. Për Kosovën, qasja universale në internet brezgjere me shpejtësi minimale prej 512 kbps me çmime konkurruese është domosdoshmëri. Megjithatë, zhvillimi i infrastrukturës në gjithë vendin nuk ka qenë i njëjtë, dhe bizneset ngurrojnë që ta zhvillojnë atë në vende të largëta. Në Kosovë njerëzit lidhen në internet kryesisht përmes teknologjive pa tela (zona rurale), ndërsa numri i njerëzve që përdorin rrjetet ekzistuese të telave të bakrit të linjave telefonike është i limituar për shkak të mbulimit të ulët (vetëm në zona urbane). Sipas Eurostatit më 2011 mesatarisht 67.3% të ekonomive familjare në Bashkimin Evropian përdornin lidhje interneti brezgjere. Për të siguruar mbulueshmëri brezgjere, sektori publik duhet të ndërmerr veprime për të evituar ndarjen dixhitale, meqë vetëm zhvillimi gjeografikisht konsistent i rrjeteve brezgjere sjell përfitime shtesë për ekonominë dhe shoqërinë si tërësi. Qeveria do të hulumtojë opsione inovative dhe kreative, duke përfshirë partneritete publike private, mekanizma alternativë të financimit, etj., për aplikimin e shërbimeve të internetit brezgjere në shkolla dhe institucione tjera akademike, institucione të shëndetit publik dhe institucione kulturore, siç janë bibliotekat. Qeveria dhe institucionet publike duhet të gjejnë mënyra për të shfrytëzuar mbështetjen financiare që ofrohet nga institucionet shumëpalëshe financiare, p.sh. Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane për Investime, me qëllim të financimit të projekteve që synojnë evitimin e ndarjes dixhitale ndërmjet zonave konkurruese dhe atyre jokonkurruese. Nëse konsiderohet si e nevojshme, Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet të përgatisë dhe miratojë planin e veprimit për shtrirjen e infrastrukturës brezgjere me qëllim të ofrimit të shërbimeve brezgjera për banorët, NVM-të dhe bujqit që jetojnë në hapësira jo konkurruese<sup>2</sup>.

Në të njëjtën kohë, një nga arsytet që shpeshherë përmendet për mungesën e investimeve është kostoja e lartë në gjendjen e sotme të vështirë financiare. Megjithatë, disa studime<sup>3</sup> kanë sugjeruar se deri në 80% të kostove të përgjithshme kanë të bëjnë me punën ndërtimore të infrastrukturës. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e kësaj kostoje të lartë (ndoshta deri në 30%) mund t'i atribuohet mos efikasitetit në procesin e realizimit, për shembull për shkak të mungesës së koordinimit të projekteve inxhinierike, pamjaftueshmërisë së shfrytëzimit të infrastrukturës ekzistuese, mungesës së bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve publike. Realizimi më i shpejtë mund të pengohet edhe nga

<sup>2</sup> Hapësira e vendit, qytetit apo fshatit që në tërësi apo pjesërisht nuk ofrohet qasje në rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike brezgjera.

<sup>3</sup> - WIK, 2008, Raporti i Francisco Caio, 2008, Analysys Mason, 2008

procedurat e gjata, jo transparente dhe shpeshherë të rënda për rregullimin e së drejtës për shteg (ang. Rights of Way) dhe sigurimit të të gjitha lejeve të nevojshme në nivel qendror apo lokal.

Përvoja nga shtetet e Bashkimit Evropian tregon se mund të merren masa praktike për t'i mundësuar investimet në një mënyrë me efikase, më pak të kushtueshme – dhe në të njëjtën kohë duke rritur konkurrencën. Përmes një varg masash të thjeshta dhe relativisht të pakushtueshme mund të ulen shpenzimet në masë të madhe, si për shembull përmes përdorimit më intensiv të tubacioneve ekzistuese, duke përfshirë ato që janë në pronësi të shërbimeve tjera publike (p.sh. transporti, kanalizimi, energjia, etj.) apo koordinimit më të mirë të projekteve inxhinierike. Për më tepër, disa nga mos efikasitetet në proces mund të evitohen përmes informimit më të mirë dhe duke ulur barrën administrative për kompanitë që janë të gatshme për të investuar.

Prandaj, është me rëndësi që si pjesë e angazhimeve për realizimin e synimit të këtyre Politikave për sa i përket shtrirjes së infrastrukturës së komunikimeve elektronike të parashihen hapa konkret për të arritjen e kursimeve.

Orientimet dhe objektivat e Politikave duhet të kenë parasysh edhe disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të spektrit frekuencor të nevojshëm për krijimin dhe funksionimin të tregut të komunikimeve elektronike në Kosovë. Spektri frekuencor është resurs publik kyç për sektorin dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përfshirë shërbimet mobile brezgjera pa tela, prandaj masat rregullatore për spektrin frekuencor kanë implikime ekonomike, të sigurisë, implikime shëndetësore, të interesit publik, kulturorë, shkencore, mjedisore dhe teknike. Planifikimi me kohë dhe koordinimi strategjik i përdorimit të spektrit frekuencor krijon mundësi të reja për inovacione dhe vende pune, si dhe në të njëjtën kohë kontribuon në rimëkëmbjen ekonomike dhe kohezionin social. Strategjia e Evropës 2020, merr parasysh potencialin e madh të shërbimeve pa tela në promovimin e ekonomisë së bazuar në dije, në zhvillimin dhe ndihmën për sektorët tjerë që mbështeten në TIK dhe tejkalimin e ndarjes dixhitale. Siç është theksuar në Axhendën Dixhitale për Evropën, infrastruktura brezgjere pa tela (wireless) është mjet i rëndësishëm për të nxitur konkurrencën, mundësin e zgjedhjes nga konsumatorët dhe për qasjen në vendet rurale dhe vendet tjera ku shtrirja e infrastrukturës fikse brezgjere është e vështirë apo ekonomikisht e pajustificueshme. Mundësitë e rritura të infrastrukturës brezgjere pa tela janë vendimtare në ofrimin e platformave të reja shpërndarëse për sektorin e kulturës, duke krijuar mundësi për zhvillimin e suksesshëm të atij sektori dhe ekonomisë në tërësi.

Numri i shkeljeve të sigurisë së rrjeteve dhe sigurisë së informatave është duke u rritur me shpejtësi. Kjo shkakton humbje financiare dhe krijon rreziqe dhe kërcënime të reja për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit. Është e domosdoshme që të ndërmerren hapa për zhvillim të sigurt të Shoqërisë së Informacionit duke rregulluar si duhet marrëdhëniet publike

në këtë fushë. Është tejet e rëndësishme që të bëhen ndryshimet ligjore ashtu që sistemi aktual ligjor të mos jetë pengesë për përparimin teknologjik, por, përkundrazi, të kontribuojë në të: ato duhet t'iu përshtaten marrëdhënieve ekzistuese publike dhe të ofrojnë mbrojtje adekuate për shfrytëzuesit, të rrisin besimin e tyre në teknologjitë e informacionit dhe të inkurajojnë përdorimin e avancuar dhe të sigurt të TIK-ut. Duhet të ndërmerren veprime dhe masa specifike për të ndërgjegjësuar shoqërinë, në nivel nacional, lidhur me rreziqet potenciale në fushën e sigurisë së rrjeteve dhe informatave për eliminimin e këtyre rreziqeve, përfshirë mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet ilegale në hapësirën kibernetike. Incidentet e sigurisë që ndikojnë në funksionimin e duhur të rrjeteve dhe shërbimeve, që ndërhyjnë në privatësinë e komunikimit apo vjedhin informata konfidenciale, duhet të menaxhohen në nivel nacional duke u mbështetur në praktikat më të mira botëror për menaxhimin e incidenteve të tilla nëpërmjet krijimit të Ekipit për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike - Computer Emergency Response Team (CERT). Sulmet kibernetike në sistemet informative të infrastrukturës kritike nacionale mund të kenë pasoja të rënda në funksionalitetin e tyre duke shkaktuar edhe humbje të mëdha financiare, prandaj duhet të ndërmerren masa të forta të sigurisë për ta mbajtur në nivel më të lartë sigurinë e kësaj infrastrukture.

#### ***4.2. Fusha problemore: Zhvillimi i shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike dhe promovimi i shfrytëzimit të tyre***

Shumica e shërbimeve publike dhe administrative online janë shërbime komplekse, d.m.th. informatat e nevojshme për të ofruar shërbime publike dhe administrative ruhen në disa organe dhe autoritete publike, të cilat ofrojnë shërbime publike dhe administrative online. Aktualisht, shumë pak shërbime publike janë bartur në hapësirën kibernetike të Kosovës dhe ato nuk përdoren shpesh. Një numër i vogël i shërbimeve publike dhe administrative janë transferuar në mediumin elektronik në Kosovë krahasuar me shtetet e BE-së (deklarimi i të ardhurave apo pasurisë, kërkimi për vende pune, lëshimi i dokumenteve personale, deklarimi dhe pagesa për Tatimin në Paga dhe Kontribute Pensionale, e-banking, etj.). Sipas Raportit të 9-të krahasimor ([http://ec.europa.eu/information\\_society/newsroom/cf/item-detail-dae.cfm?item\\_id=6537](http://ec.europa.eu/information_society/newsroom/cf/item-detail-dae.cfm?item_id=6537)), që ka të bëjë me disponueshmërinë e plotë të shërbimeve publike dhe administrative online, BE-ja ka arritur një mesatare prej 82% në vitin 2010 (krahasuar me 69 % më 2009). Në të njëjtën kohë, duhet të merret parasysh se interneti është duke u bërë mjet i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve. Pengesat për disa qytetarë që të i'u qasen këtyre shërbimeve (ueb faqet që nuk janë të zhvilluara me tipare të qasjes së lehtë) çon në përjashtim social dhe ka ndikime negative ekonomike. Prandaj, gjersa marrim hapa drejt transferimit të shërbimeve administrative në internet, duhet të sigurohet se ueb faqet e sektorit publik (dhe ueb faqet që ofrojnë shërbime bazike për qytetarët) janë plotësisht të qasshme.

Është me rëndësi të sigurohet mbijetesja e gjuhëve të Kosovës në shoqërinë globale të informacionit, në të cilën dominon gjuha angleze. TIK-u mund të ndihmojë në shpërndarjen e

gjerë të informatave për kulturën e Kosovës dhe të kontribuojë në ruajtjen dhe fuqizimin e shumëllojshmërisë kulturore evropiane si dhe kultivimin e veçorive nacionale. Për institucionet, siç janë bibliotekat, arkivat, muzetë dhe organet tjera që mbrojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës, TIK-u hap mundësi të reja duke siguruar ruajtjen e trashëgimisë së studimeve të rëndësishme hulumtuese si dhe burimet edukative dhe artistike të cilat rrezikohen me kalimin e kohës, si dhe integrimin dhe përhapjen e tyre në hapësirën elektronike të trashëgimisë kulturore botërore.

Një numër i caktuar i bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë ngurrojnë të përdorin teknologjitë e reja, duke iu frikësuar proceseve të komplikuara të e-biznesit që kanë të bëjnë me veprimtarinë e operatorëve të ndryshëm afarist. Këto kompani ikin nga kostot shtesë që rezultojnë me futjen e teknologjive të reja, duke dyshuar në përparësitë e tyre dhe në shumë raste kanë mungesë të kapaciteteve njerëzore për zhvillimin e TIK-ut dhe e-biznesit. Përveç kësaj, banorët dhe bizneset që praktikojnë biznes online shpeshherë përballen me pasiguri që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre dhe mbrojtjen ligjore. Aktualisht, Kosova nuk ka modele aktive për shpërndarjen dixhitale të përmbajtjes audiovizuale dhe nuk administron të drejtat e autorit në internet, për shkak se nuk ka menaxhim të përgjithshëm të të drejtave të autorit në përputhje me përparimin teknologjik që është i domosdoshëm për të rritur transparencën dhe mbikëqyrjen. Në anën tjetër, konsumatorët e Kosovës nuk kanë qasjen në ueb faqe të huaja audiovizuale ku mund t'i marrin kopjet e ligjshme. Për shkak të këtyre arsyeve, nuk ekziston një treg i përbashkët i BE-së për përmbajtjet elektronike (informata, e-shërbime) dhe kjo ndarje kufizon kërkesën për e-shërbime ndërkufitare si dhe e-tregtinë dhe operacionet përkatëse. Për shkak të kësaj, banorët e Kosovës nuk kanë shfrytëzuar sa duhet mundësitë që ofrohen nga e-Tregtia: një numër shumë i vogël i popullatës blen mallra apo shërbime online (mesatarja e BE-së: 34% - <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=tin00067&plugin=1>), ndonëse numër shumë më i madh kërkojnë informata për shërbime apo mallra në internet (mesatarja e BE-së: 51%).

#### ***4.3. Fusha problemore: Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut***

Një numër i konsiderueshëm i banorëve të Kosovës përdorin kompjuter apo internet çdo ditë: interneti përdoret për deklarin e tatimeve, për t'iu qasur shërbimeve bankare, për të kërkuar informata profesionale apo argëtuese. Megjithatë, disa grupe të caktuara (të synuara) të popullatës së Kosovës nuk përdorin kompjuter apo internet, apo ato i përdorin rrallëherë. Pasi që gjithnjë e më shumë aktivitete ditore tanimë kryhen nëpërmjet internetit, të gjithë banorëve të Kosovës iu duhet që të avancojnë shkathtësitë e tyre dixhitale për të qenë pjesë e plotë e shoqërisë. Për më tepër, për të përfituar plotësisht nga përmbajtjet dhe shërbimet e reja elektronike personat me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi të posaçme. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (në tekstin e mëtejme "Agjencia e Statistikave"), grupet në vijim përdorin TIK-un shumë rrallë:

a. Të moshuarit. Përqindje shumë e ulët e të moshuarve mbi 65 vjeç përdorin kompjuterin dhe internetin, krahasuar me përqindjen e atyre që përdorin kompjuterin dhe internetin brenda grup moshës 16–24 vjeç.

b. Popullata rurale. Më 2011, 47.38 % të ekonomive familjare rurale kishin qasje në internet (krahasuar me 69.76 % të ekonomive familjare në zonat urbane).

c. Banorët me të hyra të ulëta. Gjithashtu, përqindje e ulët e ekonomive familjare me të ardhura të ulëta kanë qasje në internet, krahasuar me përqindjen e ekonomive familjare me të ardhura mbi 1000 €.

Personave me aftësi të kufizuara duhet të ju mundësohet që të jenë pjesë e plotë e Shoqërisë së Informacionit, si dhe të kenë qasje në materiale dixhitale (libra dhe publikime të tjera), në pajtim me obligimet sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara<sup>4</sup>. Përveç qasjes në internet, qasja në komunikimet elektronike (posaçërisht në numrin e emergjencës 112) dhe shërbimet audiovizuale (posaçërisht televizion dixhital) ka rëndësi të veçantë. Përmirësimi i qasjes në TIK do t'i ndihmojë pjesëtarët e grupeve sociale në pozita të pafavorshme sociale që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shoqërinë dixhitale dhe të kenë mundësi të barabarta në kuptim të ndërveprimit social, punësimit, jetës së përditshme dhe mbrojtjes në rastet e emergjencave. Mjetet speciale për TIK për personat me aftësi të kufizuara janë më të kushtueshme dhe nuk janë në dispozicion të gjerë sikurse pajisjet e rregullta; veç kësaj, informatat e ofruara në ueb duhet t'i përmbushin standardet speciale të qasjes për të qenë të shfrytëzueshme nga personat me nevoja të veçanta. Ndonëse Kosova ka hartuar projektligje për të siguruar përshtatshmëri të mjedisit të informacionit për avancimin e integritit social të personave me aftësi të kufizuara përmes përdorimit të TIK-ut, përfshirja e këtyre personave në Shoqërinë e Informacionit ka qenë proces i vështirë. Për sa i përket qasjes në komunikimet elektronike, disa dispozita të rëndësishme janë transpozuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe tani është me rëndësi vendimtare zbatimi i atyre dispozitave ashtu që të sigurohet mundësia e qasjes në komunikimet elektronike në praktikë.

Gjersa tregu i punës po ndryshon thelbësisht, është e qartë se shkathtësitë e reja do të jenë të nevojshme për punët e së nesërme. Sipas Axhendës Dixhitale 90% e vendeve të punës në të ardhmen e afërme do të kërkojnë një nivel të shkathtësive në TIK. Mungesa e shkathtësive adekuata në disa sektorë apo profesione tanimë është e pranishme krahas papunësisë në vend. Numri i të rinjve që studiojnë dhe zgjedhin karrierë në TIK është duke rënë edhe në Evropë dhe nuk po përcjellë kërkesën në rritje. Në këtë kontekst të mungesës së përgjithshme të punonjësve në sektorin e TIK-ut, Axhenda Dixhitale thekson se gratë janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet në sektorin e TIK-ut. Për të realizuar mundësi plotësisht të barabarta dhe për t'i fuqizuar ato që të marrin pjesë tërësisht në Shoqërinë e

---

<sup>4</sup> - <http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>



Informacionit, duhet të promovohet një pjesëmarrje më e lartë e të rejave në fuqinë punëtore të TIK.

Sot e-Mësimi (e-learning) nuk është sa duhet i pranishëm në politikat e arsimit dhe aftësimin dhe kornizën ligjore të Kosovës. Ndonëse Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka hartuar Draftin e Strategjisë për Mësimin Elektronik duhet të merren hapa të mëtejme për t'i përmbushur synimet e parapara. Megjithatë, përfitimet e e-Mësimin janë të mëdha: i mundëson njerëzit që t'i përvetësojnë shkathtësitë e tyre kudo, në çdo kohë; nxitë mësimdhënësit që të praktikojnë elemente të reja, që t'i përshtatin intervenimet e tyre bazuar në nevojat personale të të mësuarit dhe të individualizojnë vlerësimin. Gjithashtu, ajo mundëson të mësuarit e vetë-rrregulluar dhe joformal, akomodon stile të ndryshme të të mësuarit, praktika inovative bashkëpunuese të të mësuarit dhe mbështetë trajnime më efikase të fuqisë punëtore, në nivel global, duke përmirësuar rezultatet, ulur kostot e trajnimit dhe kohën e duhur për arritjen e shkathtësive. Prandaj, është me rëndësi që Kosova të adresoj fuqishëm e-Mësimin në politikat vendore për modernizimin e arsimit dhe aftësimin, përfshirë kurrikulin, vlerësimin e rezultateve të të mësuarit, dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe trajnuesve.

#### **4.4. Fushat tjera problemore:**

4.4.1. Është politikë e përgjithshme që Kosova duhet të kërkojë dhe duhet t'i jipet një kod thirrës telefonik ndërkombëtar (“kodi shtetëror”) sa më parë që të jetë e mundur, duke e ditur rëndësinë për shtetin në nivelin ndërkombëtar të dhënies së të drejtës së posedimit të kodit ndërkombëtar telefonik dhe ndikimit në ekonominë e Kosovës si tërësi posaçërisht në nivel të konkurrencës në tregjet ndërkombëtare.

4.4.2. Sigurimi i Kodit Shtetëror për Krye-Domen (ang. country code *Top Level Domain* – ccTLD, i njohur edhe si “kodi shtetëror për Internet”) për Kosovën është aspekt i rëndësishëm në promovimin dhe lehtësimin e përdorimit komercial të Internetit. Është synim i përgjithshëm politik që Kosova duhet të kërkojë, dhe asaj duhet t'i jipet kodi shtetëror për Internet në kuadër të procedurave formale për marrjen e kodit shtetëror për Internet përmes Korporatës së Internetit për Caktimin e Emrave dhe Numrave - *Internet Corporation for Assigned Names and Numbers (ICANN)* dhe Agjencionit Shërbyes ISO 3166 të Kombeve të Bashkuara (ISO 3166/MA) sa më herët që është e mundur.

Megjithatë, një numër nismash mund të ndërmerren në pritje të zgjidhjes së tillë, që do të mund të thjeshtësonte çështjet operationale për sa i përket marrjes së kodit shtetëror për Internet. Në veçanti, ARKEP udhëzohet që sa më parë t'i ndërmerr nismat e nevojshme në pajtim me detyrimet e përcaktuara nga ICANN.

Duke marrë parasysh Programin për Krye-Domene të Reja gjenerike (ang. generic Top-Level Domain - gTLD) të zhvilluar nga ICANN-i që synon rritjen e konkurrencës dhe zgjidhjen përmes futjes së gTLD-ve të reja në sistemin e adresave të Internetit, ARKEP udhëzohet që t'i kryejë analizat dhe përgatitjet për aplikimin e Kosovës në ICANN për ndarjen e gTLD-ve “.ko” dhe “.ks” sapo të jetë shpallur ftesa për aplikime të reja nga ICANN.

Aktivitetet e ARKEP-it në lidhje me kodin shtetëror të internetit dhe gTLD-ve do të koordinohen ngushtë me MZHE-në.

4.4.3. Duke siguruar të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, operatorët publik të telefonisë duhet t'i vënë informatat e lokacionit në dispozicion për autoritetet që merren me emergjenca, për aq sa është teknikisht e realizueshme, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin për thirrje emergjente 112. Për të lehtësuar dhënien e informatave të lokacionit të thirrësve dhe shërbimet e e-Thirrjes, duhet të ndërmerren veprime nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore, duke marrë parasysh Rekomandimin e Komisionit 2003/558/EC për përpunimin e informatave të lokacionit të thirrësve në rrjetet e komunikimeve elektronike për qëllim të shërbimeve thirrëse emergjente me përcaktim të lokacionit<sup>5</sup> dhe Rekomandimin e Komisionit 2011/750/EU për mbështetjen për shërbimin mbarë evropian të e-Thirrjes në rrjetet e komunikimeve elektronike për transmetimin e thirrjeve emergjente brenda automjeteve bazuar në 112 (‘eThirrjet’)<sup>6</sup>.

Është politik e QeK që Sistemi i Integruar Informatik për shërbimet e emergjencave duhet të avancohet edhe më tutje në mënyrë që ti përmbush të gjitha nevojat për këto shërbime.

Komunat luajnë rol të rëndësishëm për ndërtimin e infrastrukturës së TIK-ut, përderisa bëjnë lëshimin e lejeve relevante, për bashkë-shfrytëzimin e infrastrukturës publike relevante të cilat mund të përdoren për vendosjen e infrastrukturës së rrjetit brezgjere, etj. Gjatë procesit të konsultimit publik me palët e interesit, si: IPKO, PTK-ja, ato kanë shprehur shqetësime në lidhje me nxjerrjen e lejeve në nivelin komunal, të cilat e bëjnë procesin e përgjithshëm të zgjerimit të infrastrukturës brezgjere në Republikës së Kosovës shumë më të ngadalshëm dhe më të kushtueshëm. Këto Politika parashikojnë veprime të caktuara të cilat duhet të ndërmerren në nivelin komunal, mirëpo Qeveria nuk ka fuqi për të ndikuar në mënyrë direkte në vendimet e komunave. Prandaj duhet të gjenden mekanizma për të bashkëpunuar me komunat në mënyrë që të arrihen objektivat e Politikave.

Për të kontribuar në zhvillimin e TIK-ut është aprovuar “Strategjia Nacionale për Shoqëri të Informacionit 2006-2012”, “Strategjia për Qeverisje Elektronike 2009-2015”, si dhe është aprovuar Ligji për Komunikimet Elektronike i cili transponon kornizën rregullatore të Bashkimit Evropian për komunikimet elektronike të viteve 2002 dhe 2009.

<sup>5</sup><http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:189:0049:0051:EN:PDF>

<sup>6</sup><http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:303:0046:0048:EN:PDF>

Në kuadër të Iniciativës elektronike të Evropës Juglindore (eSEE Initiative) dhe në bashkëpunim me Akademinë për eQeverisje të Estonisë janë bërë hapat e parë për zbatimin e projektit TID+. Implementimi i këtij projekti do të zgjerojë mundësitë e qytetarëve për participimin në bërjen e politikave publike.

Projekti për trajnimin dhe certifikimin e mësimeve me ECDL (European Computer Driving Licence) i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është në proces të zbatimit. Deri më tani, janë certifikuar më shumë se 1940 mësues (nga më shumë se 10000 mësues të trajnuar). Ky program realizohet nga Universiteti Amerikan i Kosovës (AUK) dhe do të zgjasë dy vite, dhe rreth 27 mijë mësime në Republikën e Kosovës janë të detyruar të kalojnë atë.

Ekzistojnë programe për mësimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të qeverisë në fushën e TIK-ut përmes "Institutit Kosovar për Administratë Publike". Për momentin nuk ka të themeluar ndonjë Rrjet Akademik për Hulumtime por Këshilli Kombëtar për Hulumtime ka përgatitur "Programin Kombëtar për Hulumtime të Republikës së Kosovës" në kuadër të prioriteteve të të cilit është edhe prioriteti: Hulumtimet Ndër-Horizontale për Teknologjitë Informative dhe Komunikuese. Në kuadër të zbatimit të këtij programi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së fundmi ka filluar që çdo vit të publikojë ftesë për konkurrim të institucioneve të shkencës të Kosovës dhe të studiuesve kosovarë që të konkurrojnë për të marrë grante shkencore në disa kategori, ku njëra prej fushave shkencore prioritare është edhe Hulumtimet Ndërdisciplinore në fushën e TIK-ut. Këto programe kanë një vlerë financiare prej 1-2 milion Euro.

Portali Qendror i e-Qeverisjes [www.rks-gov.net](http://www.rks-gov.net) u prezantua në 2009 si një portë për disa shërbime dhe si linçe të dobishme të entiteteve tjera.

Ekziston një program për dixhitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe historike që ka filluar të zhvillohet në bashkëpunim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë, ku do të krijohet një bazë të dhënash elektronike lidhur me trashëgiminë kulturore të Kosovës, si dhe një program i dixhitalizimit të objekteve kulturore. Baza e të dhënave do të përfshijë informacione për të gjitha monumentet kulturore dhe për vlerat e pronave të ndryshme kulturore në Kosovë. Baza e të dhënave është projektuar dhe dixhitalizimi i një inventar prej rreth 2.700 artefakteve është në fazën e zbatimit.

Gati të gjitha vendimet që kërkojnë diskutim publik, dhe draftet e tyre, në dispozicion për diskutim online janë duke kaluar nëpër konsultime publike.

Në aspekt të nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe bizneseve, si pjesë e shërbimeve të qeverisjes elektronike, mund të thuhet se ende pak shërbime të e-Qeverisjes ofrohen dhe mënyra dominuese e përdorimit të e-Shërbimeve është ndërveprimi i njëkahshëm, si psh.

marrja e informacionit, shkarkimi i formave, iniciimi i aplikimit, dhe shumë pak ndërveprime të dy anshme.

## **5. Objektivat**

Objektivi strategjik i Politikave është përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e Kosovës si dhe mjedisin afarist për kompanitë përmes shfrytëzimit të mundësive të krijuara nga TIK-u dhe rritja e përqindjes së përdoruesve të internetit në Kosovë deri në së paku 85% deri në vitin 2020.

Shoqëria e Informacionit duhet të zhvillohet në bazë të objektivave strategjike si në vijim, të cilat janë bazuar në problemet e identifikuar në kapitujt më lartë:

1. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut (në tekstin e mëtejme "Prioriteti 1");
2. Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre (në tekstin e mëtejme "Prioriteti 2");
3. Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut (në tekstin e mëtejme "Prioriteti 3").

## **6. Alternativat e konsideruara**

Veprimet e përcaktuara me këto Politika nuk shkojnë përtej zotimeve ndërkombëtare të marrura nga Qeveria e Kosovës me nënshkrimin e "eSEE Axhendës Plus" dhe "Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2012" si dhe miratimit të dokumenteve të përmendura më lart në nivel kombëtar.

Alternativë do të ishte mos parashikimi i veprimeve që korrespondojnë me "eSEE Axhendën Plus" dhe "Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2012" në kuadër të këtyre Politikave. Kjo alternativë do të nënkuptonte se Republika e Kosovës nuk do të zbaton zotimet e saja ndërkombëtare. Prandaj kjo alternativë nuk duhet të mbështetet, sepse ajo nuk do të përmbushte zotimet ndërkombëtare tashmë të bëra.

Ekipi Punues i krijuar me vendim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik - Nr.2096, datë 07.09.2012 nuk ka identifikuar alternativa të tjera përveç atyre të përshkruara më sipër.

## **7. Qasja e rekomanduar**

Duke marrë parasysh analizat e fushave problemore të bëra në kapitullin 4, si dhe objektivat strategjike të sugjeruara për të adresuar ato fusha dhe alternativat e diskutuara në kapitullin 6, si dhe kontributet e ofruara nga institucionet pjesëmarrëse dhe palët e interesit janë formuluar veprimet e parashikuara në Aneksin e këtyre Politikave.

Më poshtë janë paraqitur veprimet të cilat janë konsideruar të jenë mënyra më efektive për arritjen e objektivave të identifikuar në Kapitullin 5.

Për Prioritetin 1 “Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut” përcaktohen Objektivat në vijim:

1.1. Objektivi i parë është që të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik i rrjeteve të komunikimit elektronik brezgjere në tërë territorit nacional dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimit elektronik (në tekstin e mëtejme “Objektivi 1 në Prioritetin 1”).

1.2. Objektivi i dytë është që të arrihet siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të rritur besimin e publikut dhe bizneseve në hapësirën kibernetike (në tekstin e mëtejme “Objektivi 2 në Prioritetin 1”).

Për Prioritetin 2 “Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre” përcaktohen objektivat në vijim:

2.1. Objektivi i parë është që të inkurajohen banorët në shfrytëzimin e shërbimeve publike dhe administrative online, si dhe të sigurohet cilësia e bartjes së të dhënave dhe infrastruktura e funksionimit të sistemeve të kërkimit, duke kontribuar në zhvillimin e e-demokracisë (në tekstin e mëtejme “Objektivi 1 në Prioritetin 2”).

2.2. Objektivi i dytë është përdorimi i TIK-ut për të promovuar kulturën dhe gjuhët e Kosovës (në tekstin e mëtejme “Objektivi 2 në Prioritetin 2”).

2.3. Objektivi i tretë është promovimi i zhvillimit të e-biznesit (në tekstin e mëtejme “Objektivi 3 në Prioritetin 2”).

Për implementimin e Prioritetit 3 “Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK-ut” përcaktohet objektivi në vijim:

3.1. Është objektivi që të inkurajohen banorët e Kosovës që t’i përvetësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për përdorim të suksesshëm të TIK-ut dhe të përfshihen në Shoqërinë e Informacionit, për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetës dhe për të zvogëluar përjashtimin e tyre social (në tekstin e mëtejme “objektivi i Prioritetit 3”), si dhe të krijojnë kushtet e nevojshme për këtë.

Për momentin sektori i TIK-ut nuk matet në kuptim të Statistikave, dmth. nuk zhvillohet Sistem Statistikor në nivel kombëtar. Kjo nënkupton se ekziston rreziku se progresi në zbatimin e Politikave nuk mund të matet, njëjtë sikur edhe pika referente ekzistuese.

Me qëllim të zbutjes së një rreziku të tillë Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të sigurojë mbledhjen e të dhënave, përgatitjen dhe ofrimin e informatave statistikore për kriteret e vlerësimit të Politikave të listuara në Aneksin e Politikave, që do me thënë:

1. banorët të cilët e përdorin internetin rregullisht (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);

2. banorët që përdorin pajisje që mundësojnë qasje në shërbimet elektronike (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
3. banorët të cilët nuk e përdorin internetin (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
4. banorët që punojnë në sektorin e TIK-ut (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
5. personat e moshës 16–74 të cilët e përdorin internetin për qëllime të mësimi (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
6. banorët të cilët përdorin shërbimet publike dhe administrative online (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
7. banorët të cilët mund t’iu qasjen shënimeve të tyre shëndetësore online nga cilido vend (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
8. banorët të cilët përdorin shërbimet online që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore të Kosovës (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
9. banorët të cilët përdorin shërbimet online që kanë të bëjnë me gjuhët e Kosovës (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
10. banorët të cilët kanë blerë (porositur) produkte apo shërbime nëpërmjet internetit (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
11. ndërmarrjet që përdorin sisteme të planifikimit të resurseve të lidhura me sisteme partnere (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend);
12. ndërmarrjet që përdorin sisteme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientë (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend);
13. ndërmarrjet që kanë blerë (porositur) mallra apo shërbime në rrjete elektronike (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend);
14. ndërmarrjet që kanë shitur mallra apo shërbime në rrjete elektronike (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend);
15. banorët të cilët kanë mundësi të kenë qasje në rrjetet brezgjera (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit);
16. ekonomitë familjare që kanë mundësi të përdorin internet brezgjërë (përqindja e gjithsej ekonomive familjare);
17. ndërmarrjet që kanë mundësi të përdorin internet brezgjërë (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve);

Institucionet që janë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve kyçe dhe koha e veprimeve janë të listuara në Aneksin e këtyre Politikave.

## **8. Hapat e ardhshëm, për zbatimin e strategjisë – Zbatimi i Politikave dhe llogaridhënia**

Zbatimi i Politikave do të koordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (në tekstin e mëtejshëm “Koordinatori i Politikave”).

Zbatimi i detyrave të Politikave do të jetë përgjegjësi e autoriteteve publike të listuara në shtojcën e Politikave.

Zhvillimi i Shoqërisë së Informacionit mbulon proceset horizontale në një numër sektorësh të ekonomisë dhe administratës publike, prandaj Politikat zbatohen në pajtim me Planin e masave për zbatimin e Politikave (plani i veprimit, në tekstin e mëtejme – Plani) në koordinim me autoritetet dhe organet publike përgjegjëse për zbatimin e detyrave të Politikave (në tekstin e mëtejme “autoritetet kompetente”). Plani duhet të përmbajë masat specifike të nevojshme për zbatim të Politikave. Autoritetet kompetente në planet e tyre vjetore të punës të paraqitura në Qeveri dhe Kuvend respektivisht për aprovim duhet të përfshijnë masa dhe aktivitete konkrete që dalin nga dokumenti i Politikave.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në baza vjetore e bënë rishikimin e masave të ndërmarra, punëve të kryera, rezultateve të arritura, problemeve në zbatimin e masave, masave që nuk janë zbatuar, si dhe ndryshimeve në kriteret e vlerësimit.

Koordinatori i Politikës:

- analizon informatat e pranuar nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e detyrave të Politikave që kanë të bëjnë me masat e nevojshme për zbatimin e Politikave dhe dorëzon propozime dhe rekomandime lidhur me pajtueshmërinë e këtyre masave me prioritetet, objektivat dhe detyrat e Politikave;

- mbikëqyrë zbatimin e prioriteteve, objektivave dhe detyrave të Politikave dhe deri më 1 janar 2017, realizon një shqyrtim të përkohshëm të detyrave të përcaktuara dhe ndryshimeve në vlerat e kriterëve të vlerësimit të tyre dhe, sipas nevojës, inicion rishikim të Politikave;

- në raportin e tij vjetor të aktiviteteve, ofron informata lidhur me zbatimin e Politikave për Qeverinë. Sipas nevojës progresi i zbatimit të Politikave diskutohet në takimet e Forumit Nacional për Zhvillim të Shoqërisë së Informacionit, i cili do të krijohet pas aprovimit të këtyre Politikave.

---

## 9. Aneks

Shtojca e Politikave të Sektorit të Komunikimeve  
Elektronike – Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013–2020

### KRITERET PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT DHE VLERAT E TYRE TË SYNUARA

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator 2016	Indikator 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
0.	Kriteri për vlerësimin e objektivit strategjik është të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe mjedisit afarist për kompanitë përmes përdorimit të mundësive të krijuara nga TIK			banorët të cilët përdorin internetin në baza të rregullta (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	57	70	85	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
1.	Kriteret për vlerësimin e Prioritetit 1: Zhvillimi i infrastrukturës së TIK	1. 1. të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik i rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjere në tërë territorin e vendit dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike		Banorët të cilët kanë mundësi të kenë qasje në rrjetet brezgjere (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	75	90	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
			1. 1. 1. Të sigurohet zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjere në fushat ku tregu nuk ka arritur të sigurojë këtë zhvillim të infrastrukturës dhe ofrim të shërbimit	ekonomitë familjare që kanë mundësi të përdorin Internet brezgjere (përqindja e gjithsej ekonomive familjare)	48.5	70	80	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
				ndërmarrjet që kanë mundësi të përdorin Internet brezgjere (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve)	75	90	98	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë



NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			1. 1. 2. Avancimi i infrastrukturës së qasjes publike në Internet në biblioteka	Pika publike të qasjes në Internet me shpejtësi prej 10 Mbps apo më shumë (përqindja e të gjitha pikave të qasjes në Internet)	26	70	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
			1.1.3 Avancimi i infrastrukturës së qasjes publike në Internet në shkolla	Pika publike të qasjes në Internet për nxënës me shpejtësi prej 10 Mbps apo më shumë (përqindja e të gjitha shkollave)	-	50	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
			1. 1. 4. Nxitja e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike brezgjere, për të ngritur efikasitetin e rregullimit të tregut, dhe për të bërë përpjekje që të gjithë banorëve të Kosovës t'u sigurohet qasje në Internet me shpejtësi më të lartë se 30 Mbps deri në vitin 2020	Banorët që kanë mundësi të shfrytëzojnë lidhje Interneti prej 30 Mbps apo më shpejtë (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	70	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Infrastrukturës, Komunitat

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimit	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			1. 1. 5. Futja e masave të reja dhe ndryshimi i procedurave ekzistuese me qëllim që të kontribuohet në mënyra më të thjeshta, më të shpejta dhe me efektive për zhvillimi të infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e Kosovës	Aktet e shqyrtuara ligjore që kanë të bëjnë me zhvillimin e projektit, ndërtimin dhe përfundimin e infrastrukturës së rrjetit të komunikimeve elektronike me qëllim të thjeshtësimit të proceseve dhe procedurave (përqindja e gjithsej numrit të akteve ligjore)	-	100	100	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunat.
				Krijimi i bazës gjithëpërfshirëse të të dhënave/pikë të qasjes në informata për sa i përket lejeve, kërkesave për planifikimin e qytetit etj ;	-	100	100	Task Forca e të Bërit Biznes, Komunat: Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër; Komiteti Komunal Teknik; Korporata Energjetike e Kosovës; Ujësjetësuesit Rajonal, Agjencia e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
				Krijimi i një one-stop-shop për të gjitha lejet e nevojshme;	-	100	100	Task Forca e të Bërit Biznes; Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim; Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër; Komiteti Komunal Teknik; Korporata Energjetike e Kosovës; Ujësjiellësit Rajonal, Agjencia e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Komunat; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Infrastrukturës.
				Infrastruktura e komunikimeve elektronike (instalim i brendshëm) i instaluar në banesat e sapo ndërtuara (nëse janë 4 apo më shumë banesa) siguron se është teknikisht e mundur që çdo ekonomie familjare t'i ofrohet lidhje brezgjere prej mbi 100 Mbps (përqindja e gjithsej banesave të sapo ndërtuara)	-	100	100	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimit	Indikator i 2012	Indikator 2016	Indikator 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
				Janë miratuar rregullat për instalimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
				Është krijuar korniza që mundëson operatorët që të përfitojnë nga shpalljet e qarta të punimeve të planifikuara të inxhinierisë civile në një territor të caktuar dhe afati kohor në kuptim të shqyrtimit të mundësive të zhvillimit paralel apo vendosjes së përbashkët të infrastrukturës së rrjetit të komunikimeve elektronike;	-	100	100	Task Forca e të Bërit Biznes; Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim; Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër; Komiteti Komunal Teknik; Korporata Energjetike e Kosovës; Korporata Energjetike e Kosovës; Ujësjellësit Rajonal; Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencia e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Komunitet; Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Ministria e Infrastrukturës.

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimit	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
				Mundësia për të shtruar tubacione të reja apo infrastrukturë tjetër të komunikimeve elektronike gjatë kryerjes së punimeve publike (p.sh. ndërtimi i rrugëve apo punët e mirëmbajtjes) ofrohet sistematikisht (përqindja e gjithsej numrit të punëve të kryera publike);	-	40	100	Task Forca e të Bërit Biznes; Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim; Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër; Komiteti Komunal Teknik; Korporata Energjetike e Kosovës; Korporata Energjetike e Kosovës; Ujësjetillësit Rajonal; Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencia e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Komunitet; Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Ministria e Infrastrukturës.

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator 2016	Indikator 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
				Vënia online e informatave lidhur me infrastrukturën ekzistuese tokësore dhe nëntokësore (që mund të përdoret për futjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike), lokacionet e tyre dhe pronësinë (përqindja e gjithsej territorit të Kosovës)	-	40	100	Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Komunat
				Përcaktimi i çmimeve për bashkë-shfrytëzim të infrastrukturës publike në nivel lokal që mund të shfrytëzohet për vendosjen e rrjetave publike të komunikimeve elektronike, psh. rrugët lokale, kanalizimi, ujësjellësi, nxehja, (përqindja e numrit të përgjithshëm të infrastrukturës lokale)	-	100	100	Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Komunat, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
				Përcaktimi i çmimeve për bashkë-shfrytëzim të infrastrukturës së rrugëve publike, në veçanti të korridoreve kryesore dhe gypave të instaluar	-	100	100	Ministria e Infrastrukturës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

NR	Objekti strategjik dhe prioritetet	Objekti	Detyra	Kriteri i vlerësimit	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
				Përcaktimi i çmimeve për bashkë-shfrytëzim të infrastrukturës së gazit, në veçanti të gypave	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
				Përcaktimi i çmimeve për bashkë-shfrytëzim të infrastrukturës së elektricitetit, në veçanti të shtyllave dhe gypave	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
			1. 1. 6. Planifikimi i kërkesës për radiofrekuenca dhe koordinimi i tyre për teknologjitë e reja radiokomunikuese	Ndryshimi i licencave të lëshuara me qëllim të përshtatjes së kushteve për përdorim të frekuencave të caktuara për teknologjitë e reja brezgjera dhe pa tela	-	100	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
				Përcaktimi i kushteve për përdorim të radiofrekuencave dhe procedurave për dhënien e brezit frekuencor 790-862 MHz për teknologjitë brezgjere dhe pa tela.	80	98	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
			1.1.7. Punët përgatitore për kodin shtetëror të internetit për Kosovë (ccTLD)	Analizimi dhe përgatitja e hapave për aplikim të Kosovës në ICANN për ndarjen e gTLD-ve “.ko” dhe “.ks” për Kosovën	-	100	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
		1. 2. Të arrihet siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të rritur besimin e publikut dhe bizneseve në hapësirën kibernetike	1. 2. 1. Zhvillimi i infrastrukturës për mbështetje dhe përdorim për kartela të identifikimit që do të garantonte identifikim dhe verifikim të besueshëm personal në hapësirën kibernetike	Banorët që përdorin kartelat personale të identifikimit për verifikimin e identitetit personal në hapësirën kibernetike (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	30	50	Ministria e Punëve të Brendshme
			1. 2. 2. Krijimi i një infrastrukture për menaxhimin e dokumenteve elektronike, duke siguruar autenticitetin, integritetin dhe ruajtjen e dokumenteve elektronike	Autoritetet dhe organet qendrore dhe lokale këmbajnë dokumente elektronike duke përdorur infrastrukturën (përqindja e të gjitha autoriteteve dhe organeve qendrore dhe lokale)	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme
			1. 2. 3. Miratimi i akteve të reja ligjore dhe ndryshimi i atyre ekzistuese me qëllim të zhvillimit të kornizës së avancuar ligjore e cila arrin siguri dhe integritet të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike	Aktet e miratuara dhe të ndryshuara ligjore (përqindja e akteve ligjore)	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme
			1. 2. 4. Krijimi i CERT në nivel nacional, përgjegjës për hetimin e incidenteve të sigurisë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike	CERT nacional është themeluar dhe është tërësisht funksional	-	100	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Zhvillimit Ekonomik



NR	Objekti strategjik dhe prioritetet	Objekti	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator 2016	Indikator 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			1. 2. 5. Promovimi i kulturës së përdorimit të sigurt të rrjetit të komunikimeve elektronike, shërbimeve dhe sistemeve të informacionit	Informatat që kanë të bëjnë me rrjetet e komunikimit elektronik, shërbimet dhe sigurinë e sistemeve të informacionit janë publikisht në dispozicion dhe rregullisht azhurnohen	-	100	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punëve të Brendshme
				Veglat që kanë të bëjnë me rritjen e aftësive për tu mbrojtur nga kërcënimet e sigurisë dhe ruajtjes së privatësisë për banorët janë në dispozicion të publikut pa pagesë	-	100	100	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Punëve të Brendshme
			1. 2. 6. Luftimi i përmbajtjes jologjore në Internet, duke krijuar një sistem të thirrjeve telefonike dhe edukimit të shoqërisë (posaçërisht fëmijëve)	Linja telefonike dhe qendrat e ndërgjegjësimit janë krijuar dhe janë tërësisht funksionale	-	100	100	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Punëve të Brendshme
			1. 2. 7. Aplikimi i masave të sigurisë, menaxhimit të rrezikut, kontrollit të incidenteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, sistemet informative me qëllim të arritjes së sigurisë dhe besueshmërisë të sistemeve të informimit të sektorëve publikë dhe infrastrukturës nacionale të informatave kritike	Banorët që kanë njoftuar për probleme të sigurisë gjatë komunikimit me institucione qeveritare dhe komunale në Internet (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	1	1	Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administratës Publike, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimit	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
2.	Kriteret për vlerësimin e Prioritetit 2: zhvillimi i përmbajtjes dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre	2. 1. Të inkurajohen banorët në shfrytëzimin e shërbimeve publike dhe administrative online dhe të sigurohet cilësia e transmetimit të të dhënave dhe infrastruktura e funksionimit të sistemeve të kërkimit duke kontribuar në zhvillimin e e-demokracisë		Banorët të cilët përdorin shërbime publike dhe administrative online (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	20	40	Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministria e Zhvillimit Ekonomik
			2. 1. 1. Maksimizimi i transferimit të shërbimeve publike dhe administrative në medime elektronike, duke siguruar riorganizim të integruar të ofrimit të shërbimeve, arritja e ofrimit të centralizuar të shërbimeve, dhe inkurajimi i autoriteteve të sektorit publik që të prokurojnë resurse të TIK-ut si shërbime të jashtme	Shërbimet publike dhe administrative të transferuara në hapësirën kibernetike përbëjnë këtë nivel të pjekurisë së disponueshmërisë online të shërbimeve kryesore publike dhe administrative (në përqindje)	-	40	70	Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministria e Zhvillimit Ekonomik
				Banorët të cilët mund t'i qasjen shënimeve të tyre shëndetësore në Internet nga cilido vend (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	50	100	Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			2. 1. 2. Të informohen qytetarët lidhur me qasjen në informatat ligjore të publikuara në Internet, të inkurajohen ata të dorëzojnë komente dhe propozime online dhe në këtë mënyrë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes publike	Draft legjislatiioni në të cilin hartuesit kanë pranuar propozime nga publiku (përqindja e gjithsej draft ligjeve)	-	10	15	Ministria e Drejtësisë
			2.1.3. Zbatimi i projektit TID+ në kuadër të bashkëpunimit të Iniciativës elektronike të Evropës Juglindore (eSEE)	Projekti TID+ funksional dhe i shfrytëzuar nga qytetarët dhe institucionet relevante	-	100	100	Ministria e Administratës Publike, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
		2. 2. Përdorimi i TIK-ut në promovimin e kulturës dhe gjuhëve të Kosovës		Banorët të cilët përdorin shërbime online në lidhje me trashëgiminë kulturore të Kosovës (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	15	20	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
				Banorët të cilët përdorin shërbime online në lidhje me gjuhët e Kosovës (përqindja e gjithsej popullatës së vendit)	-	20	25	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
			2. 2. 1. Dixhitalizimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe përdorimi i saj si bazë për krijimin e produkteve dixhitale me qasje publike, duke siguruar ruajtjen dhe përhapjen e përmbajtjes dixhitale në hapësirën kibernetike	Disponueshmëria e trashëgimisë kulturore të dixhitalizuar në Internet (përqindja e të gjitha produkteve dixhitale në dispozicion)	-	45	65	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

NR	Objekti strategjik dhe prioritetet	Objekti	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			2. 2. Paraqitja e produkteve digjitale në gjuhët lokale në TIK me qëllim të sigurimit të funksionalizimit të plotë të gjuhëve lokale (me shkrim dhe me gojë) në të gjitha fushat e jetës publike	Resurse, masa dhe e-Shërbime të zhvilluara dhe në dispozicion për publikun në gjuhët lokale (përqindja e gjithsej produkteve të paraqitura në TIK)	-	25	40	Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
		2. 3. Promovimi i zhvillimit të e-biznesit		Banorët të cilët kanë blerë (porositur) produkte apo shërbime nëpërmjet Internetit (përqindja e gjithsej popullatës)	-	20	40	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
			2. 3. 1. Nxitja e bizneseve të vogla dhe të mesme që të fusin në shfrytëzim Teknologjitë Informative dhe Komunikuese për të përmirësuar efikasitetin dhe konkurrencën në funksionimin e tyre	Ndërmarrjet që përdorin sisteme të planifikimit të resurseve të lidhura me sisteme partnere (përqindja e të gjitha ndërmarrjeve në vend)	-	10	20	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
				Ndërmarrjet që përdorin sisteme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientë (përqindja e të gjitha ndërmarrjeve në vend)	-	15	30	Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator 2016	Indikator 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			2. 3. 2. Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim të e-biznesit, d.m.th. shqyrtimi i dokumenteve ligjore dhe ofrimi i sigurisë ligjore që do të mund të rriste besimin e konsumatorëve, zvogëlonte pengesat rregullative kombëtare dhe garantonte mbrojtjen të të drejtave të konsumatorëve	Ndërmarrjet që kanë blerë (porositur) mallra apo shërbime përmes formës elektronike (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend)	-	30	50	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
				Ndërmarrjet që kanë shitur mallra apo shërbime përmes formës elektronike (përqindja e gjithsej ndërmarrjeve në vend)	-	15	35	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
3.	Kriteret për vlerësimin e Prioritetit 3: avancimi i shkathtësive të banorëve të Kosovës për përdorimin e TIK-ut	3. 1. Të inkurajohen qytetarët e Kosovës për të fituar njohuri dhe shkathtësi për përdorimin e suksesshëm të TIK-ut dhe të krijohen kushtet e nevojshme për këtë		banorët që përdorin mjete të cilat mundësojnë qasje në shërbime elektronike (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit)	57	75	85	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
			3. 1. 1. Të mundësohet që grupet e synuara të popullatës së Kosovës të cilat, deri më tani për arsye të ndryshme, nuk kanë përdorur kompjuterë dhe Internet dhe nuk kanë pasur nevojë për to, t'i përvetësojnë njohuritë e nevojshme dhe t'i aplikojnë ato në fusha të ndryshme të aktiviteteve	Banorët që nuk përdorin Internetin (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit)	43	30	20	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
			3. 1. 2. Zvogëlimi i mospërputhjes ndërmjet kërkesës dhe ofertës për specialistë të TIK-ut me qëllim të arritjes së mesatares së punonjësve në sektorin e TIK-ut në BE	Banorët që punojnë në sektorin e TIK-ut (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit)	-	2. 3	3. 2	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NR	Objektivi strategjik dhe prioritetet	Objektivi	Detyra	Kriteri i vlerësimi	Indikator i 2012	Indikator i 2016	Indikator i 2020	Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kriterit
			3. 1. 3. Krijimi i kushteve fleksibile të të mësuarit të një cilësie të re në mënyrë që të mundësohet të mësuarit dhe të nxënit e personalizuar në hapësirën kibernetike	Personat e moshës 16–74 të cilët e përdorin Internetin për qëllime të mësimit (përqindja e gjithsej popullsisë së vendit)	-	15	20	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
			3.1.4. Krijimi i një portali të të mësuarit, si dhe përgatitja e programit të mësimit për shërbyesit publik që i'u mundëson fitimin e aftësive në funksionet e administratës publike	Shërbyes Publik të certifikuar sipas sistemit ECDL(European Computer Driving License), (përqindja e gjithsej shërbyesve publik)	-	30	80	Ministria e Administratës Publike, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë